



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 859/10 prot.

Datë 08.04.2026

V E N D I M
Nr. 485/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|----------------|------------|
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Anila Malaj | Anëtar |
| Gjergj Mersini | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 08.04.2026 me

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 437/2026, datë 27.03.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73589-12-31-2025, me objekt “Blerje reagentesh dhe pajisjesh për Labororet fiziko-kimik dhe bakteriologjik të Impiantit Boville për vitin 2025”, me fond limit 9,795,422.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23-01 2026 , nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” sh.p.k me NIPT L41629009A, dhe adresë: Rruga Pavaresia Ndertesë Nr. 1, Kati i Tretë, Zyra 340 dhe magazine, Mezez.
- Autoriteti Kontraktor:** SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane me adresë: Rruga e Kavajës, Ndertesë nr.133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:
I
Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 27.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 437 /2026, ku vendosi:

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Carpathia Albania” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73589-12-31-2025, me objekt “Blerje reagentesh dhe pajisjesh për Labororet fiziko-kimik dhe bakteriologjik të Impiantit Boville për vitin 2025”, me fond limit 9,795,422.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23-01 2026 , nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Carpathia Albania” Shpk, në buxhetin e shtetit.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”

I.2. Me shkresën nr. 19468/16 prot., datë 01.04.2026, protokolluar me tonën nr. 859/7 prot., datë 03.04.2026, autoriteti kontraktor SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane, ka përcjellur shkresën mbi zbatimin e vendimit nr. 437/2026 datë 27.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në zbatim të tij për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73589-12-31-2025, me objekt “Blerje reagentesh dhe pajisjesh për Labororet fiziko-kimik dhe bakteriologjik të Impiantit Boville për vitin 2025”, me fond limit 9,795,422.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23-01 2026 , nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 19468/16 prot., datë 01.04.2026, protokolluar me tonën nr. 859/7 prot., datë 03.04.2026, autoriteti kontraktor SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane, ka përcjellur shkresën mbi zbatimin e vendimit nr. 437/2026 datë 27.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në zbatim të tij për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73589-12-31-2025,

me objekt “Blerje reagentesh dhe pajisjesh per Labororet fiziko-kimik dhe bakteriologjik te Impiantit Boville per vitin 2025”, me fond limit 9,795,422.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23-01 2026 , nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se autoriteti kontraktor ka përcjellur shkresën ku pohon zbatimin e vendimit dokumentat nga ku vërehen rivlerësimi sipas vendimit nr. 437/2026 datë 27.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga verifikimi i sistemit elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik konstatohet se autoriteti ka vijuar me rivlerësimin sipas vendimit të KPP për operatorin ekonomik në përputhje me vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73589-12-31-2025, me objekt “Blerje reagentesh dhe pajisjesh per Labororet fiziko-kimik dhe bakteriologjik te Impiantit Boville per vitin 2025”, me fond limit 9,795,422.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23-01 2026 , nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

